

SALI KADRIA**VEPRIMTARIA KOMBËTARE E DIASPORËS SHQIPTARE
NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)
GJATË VITEVE 1912 - 1924***

Ideologjia nacionaliste u shfaq më vonë në mesin e shqiptarëve të SHBA, krahasuar me nacionalizmat e diasporave të tjera ballkanike në këtë vend. Megjithëkëtë, nacionalistët e diasporës shqiptare dhanë një ndihmesë të madhe për forcimin e identitetit kombëtar shqiptar dhe në ndërtimin e shtetit shqiptar. Prandaj, studimi i këtij lloji nacionalizmi ka rëndësi, përderisa shoqëritë jashtë vendit, ishin “terren i përshtatshëm për zhvillimin e nacionalizmit”¹. Hulumtimi i mënyrës së formimit, organizimit, përbërjes, ideve dhe veprimtarisë së nacionalizmit shqiptar në Amerikë, dëshmon modelin se si është formuar nacionalizmi në mesin e diasporës shqiptare.

Në vitet 1912-1924, mendohet se në SHBA kishte rreth 40.000 deri në 50.000 emigrantë shqiptarë². Numri i shqiptarëve të vendosur aty, me siguri që duhet të ketë qenë më i madh, për shkak se një pjesë e madhe e emigrantëve nga viset shqiptare dhe nga vendet e tjera të Ballkanit, hynë në Amerikë, me dokumente identifikimi joshqiptare të lëshuara nga shtete të ndryshme³. Një pjesë e atyre që u paraqitën në zyrat e kontrollit kufitar në Ellis Island (pikë hyrëse e emigrantëve në Shtetet e Bashkuara

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Roli i SHBA-së, Uilsonit dhe diasporës shqiptare”, organizuar nga Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike, Republika e Maqedonisë, Tetovë, më 28 nëntor 2016.

¹ Benedict R. O’G Anderson, *Imagined Communities: Reflections on the origin and the spread of nationalism*, London: Verso, 1991, pp. 11-12.

² Mark Tirta, “Migrimi i shqiptarëve jashtë atdheut”, në *Kultura Popullore*, nr. 2, Tiranë: 1987, f. 119.

³ *The Albanian Struggle in the Old World and New*, compiled and written by Members of the Federal Writers’ Project of the Works Progress Administration of Massachusetts. [The Albanian Historical Society of Massachusetts.] Boston: The Writer, 1939, p. 6.

të Amerikës), ishin të pajisur me pasaporta të shtetit osman, për këtë arsye, në listat e emigracionit të zyrave amerikane, këta shqiptarë figurojnë si turq, pasi ata ishin shtetas osmanë, ndërsa një pjesë e shqiptarëve ortodoksë, regjistroheshin me pasaporta greke, për shkak të politikës së ndjekur nga shteti grek por edhe falë lidhjeve fetare që ata kishin me Patrikanën Ortodokse të Stambollit, e cila shqiptarët e besimit ortodoks i konsideronte grekë. Kjo gjendje vijoi edhe pas vitit 1913, sepse një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve, mbetën nën juridiksionin e shteteve të tjera ballkanike. Për pasojë, dokumentet zyrtare, japin një shifër të ndryshme, nga sa ishte në të vërtetë emigracioni shqiptar.

Në diasporën shqiptare të krijuar në SHBA, numrin më të madh e zinin meshkujt, ku pjesa më e madhe e tyre ishin të rinj. Numri i femrave shqiptare me banim në SHBA, erdhi duke u rritur, sidomos pas vitit 1920, kur mjaft shqiptarë vendosën të qëndrojnë atje si banorë të përhershëm⁴. Gjatë viteve 1912-1924 ishte i pranishëm fenomeni sipas të cilit, një pjesë e emigrantëve rikthehej në atdhe pas një qëndrimi prej disa vitesh atje, ndërsa mjaft shqiptarë të tjerë vazhdonin të hynin në SHBA. Rrëfimet e emigrantëve të kthyer në vendlindje, në lidhje me Amerikën, si dhe pasuria e fituar, nxiti dëshirën e bashkatdhetarëve të tjerë, për të shkuar në Amerikë⁵. Pavarësisht këtyre lëvizjeve, duhet theksuar se pas Luftërave Ballkanike e në vijim, numri i emigrantëve shqiptarë në SHBA, ka ardhur gjithnjë në rritje.

Përse nacionalizmi shqiptar në diasporën shqiptare të SHBA u bë mjaft aktiv pas vitit 1912?

Një nga faktorët kryesorë ishte fakti se në vitet 1905-1912, në Amerikë, erdhën një numër i konsiderueshëm personalitetesh të shquara të “shqiptarizmit”, si: Petro Nini Luarasi, Sotir Peci, Fan Noli dhe Faik Konica, të cilët përshpejtuan përhapjen e ideve kombëtare në mesin e emigrantëve shqiptarë. Ata nxitën shqiptarët, të mësonin gjuhën dhe kulturën kombëtare dhe njëherësh të mos harronin atdheun e tyre.

Shumica e emigrantëve shqiptarë që shkuan në SHBA, për shkaqe ekonomike dhe politike, ishin kryesisht nga Korça, Gjirokastra, Berati, si

⁴ Valentina Duka, *Shqiptarët në rrjedhat e shekullit XX*, Tiranë: Panteon & Afërdita, 2001, f. 12.

⁵ Constantine A. Demo, *The Albanians in America; the first arrivals*, published by Society “Fatbardhësia” of Katundi, Boston Mass.: 1960, p. 57.

dhe zonat përreth. Në vitet e mëvonshme, në Amerikë shkuan edhe mjaft shqiptarë nga Shqipëria e Veriut⁶ dhe krahina e Çamërisë. Prania e një numri të madh shqiptarësh të besimit ortodoks në një vend të lirë dhe demokratik si SHBA dhe këmbëngulja e Greqisë për aneksimin e viseve të tyre, u hapi sytë emigrantëve shqiptarë, duke u bërë faktorë determinues për forcimin e ndjenjës kombëtare te banorët e viseve të Shqipërisë së Jugut. Ndërkaq, prania e një numri të vogël shqiptarësh të besimit mysliman dhe katolik në SHBA, me gjuhë dhe tradita të njëjta me ato të shqiptarëve ortodoksë, forcoi më tej ndjenjën e përkatësisë së përbashkët kombëtare, si dhe nxiti më shumë harmoninë dhe tolerancën ndërmjet shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë atje⁷.

Në fillim të shek. XX, idetë kombëtare nuk ishin shumë të përhapura në mesin e emigrantëve shqiptarë. Ato u përpunuan nga personalitetet e kulturës shqiptare, si: Petro Nini Luarasi, Sotir Peci, Fan Noli, Faik Konica, Kristo Dako, Sevasti Qirjazi e të tjerë. Grupi i veprimtarëve kombëtarë shqiptarë, gjeti një terren të përshtatshëm për t'ia arritur synimeve që kishte⁸.

Në këto rrethana, intelektualët shfaqën idenë e bashkimit të të gjitha organizatave shqiptare të Amerikës, në një organizatë të vetme, e cila ishte shtruar si ide, qysh në vitin 1906⁹. Me gjithë pengesat e shumta, më 28 prill 1912, shqiptarët arritën të organizonin në Boston, mbledhjen e grupit të përfaqësuesve të shoqërive shqiptare të Amerikës, të cilët themeluan Federatën Panshqiptare “Vatra”. Shembull për organizimin e saj u bënë organizatat nacionaliste nga vende të ndryshme, të cilat manifestonin dy prirje: prirjen kulturore dhe atë politike¹⁰. Vetë emërtimi i saj, tregon se ajo simbolizonte bashkimin e të gjithë shqiptarëve të Amerikës, në një qendër të vetme, me synimin për të ndihmuar atdheun.

⁶ Josef S. Roucek, “The Albanian and Yugoslav immigrants in America, në *Revue Internationale, Etudes Balkaniques*, vol. 5-6, Beograd: 1937-1938, p. 500.

⁷ *Kombi*, nr.8, Boston Mas., 11 gusht 1906.

⁸ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra” (1912-1920)*, Tiranë: Globus R, 2001, f. 17.

⁹ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 100, Viti (më tej: V.) 1915, Dosja (më tej: D.) 9, fl. 1-2. Raport i një personi [të cilit nuk arrihet t'i lexohet emri – S.K.] drejtuar Federatës “Vatra”, Natick Mass., 1 Vjesht’ e parë 1915.

¹⁰ *Dielli*, nr. 2398, Boston, Mass., 31 mars 1922, f. 1-2.

Menjëherë pas themelimit të “Vatrës”, veprimtarët kryesorë u ngarkuan me detyrën e organizimit të degëve të saj në mesin e diasporës shqiptare të Amerikës. Pas kapërcimit të mjaft vështirësive, u arrit që në vitet 1918 - 1920, “Vatra” të kishte në SHBA, 62 degë, nga 12 që kishte më 1912¹¹.

Themelimi i “Vatrës” ndikoi në përhapjen dhe forcimin e nacionalizmit shqiptar. Drejtimi kryesor i punës së “Vatrës”, ishte përhapja e shtypit dhe botimeve me karakter kombëtar. Drejtuesit e saj mendonin se zhvillimi i punës së tyre në këtë hulli, do të ndikonte për bashkimin e shqiptarëve, por edhe për “demaskimin” e propagandës greke të përhapur në mesin e shqiptarëve të Amerikës. Tirazhi i gazetës “Dielli” arriti në 1.500 kopje brenda një viti, nga 600 që kishte qenë më parë. Gjithashtu, u rrit numri i botimeve në gjuhën shqipe, si dhe në dy gjuhë anglisht - shqip.

“Vatra” u kthye në një nga qendrat më të fuqishme kombëtare shqiptare¹². Gazeta “Dielli” shprehte kënaqësinë se, nga viti 1905 e deri në atë kohë, kishin përparuar mjaft idetë kombëtare. “Rreth Vatrës Shqiptare”, - shkruante gazeta “Dielli”, “po mblidheshin të gjithë shqiptarët e SHBA, që të ngroheshin me zjarrin e shqiptarizmit por edhe për të biseduar për nevojat e atdheut”¹³.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912, u mirëprit nga diaspora shqiptare në SHBA, e cila shprehu jo vetëm vendosmërinë për të mbështetur Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, si përfaqësuese e të gjithë kombit shqiptar¹⁴, por shqiptarët e Amerikës u zotuan se do të jepnin ndihmesën e tyre, për ta bërë atë një shtet modern evropian¹⁵. Pavarësisht mangësive që u vërejtën në fillesat e veprimtarisë së Qeverisë së Përkohshme, si rrjedhojë e influencave të jashtme dhe të brendshme, drejtuesit e “Vatrës”, hodhën poshtë propagandën e shteteve fqinjë për paaftësinë shtetformuese të shqiptarëve, si dhe shfaqën bindjen se, shqiptarët do të arrinin të ndërtonin shtetin e tyre.

¹¹ Constantine A. Chekrezi, *Albania Past and Present*, New York: Macmillan Company, 1919, p. 231.

¹² Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit*, përkthyer nga Xhelal Fejza, Tiranë: Dituria, 1999, f. 40.

¹³ *Dielli*, nr. 260, Boston, Mass., 7 nëntor 1913, f. 1.

¹⁴ *Po aty*, nr. 237, Boston, Mass., 19 gusht 1913, f. 1.

¹⁵ *Po aty*, nr. 232, Boston, Mass., 1 gusht 1913, f. 2.

Intelektualët shqiptarë kërkonin të përcillnin në atdhe, frymën e modernizmit, larg influencës turke dhe greke. Udhëheqësit e “Vatrës”, përcaktuan si faktor të rëndësishëm për zhvillimin dhe stabilizimin e shtetit shqiptar, forcimin e ndërgjegjes kombëtare, ie cila duhej të prevalonte mbi besimet fetare. Vetëm në këtë mënyrë, ata mendonin se shqiptarët do të mund t’i bënin ballë presionit të madh grek dhe sllav.

Për bashkimin dhe forcimin e kohezionit të shqiptarëve të Amerikës, rreth Federatës Panshqiptare “Vatra”, ndikuan disa faktorë:

Së pari, ishin vrasjet dhe masakrat që kryen grekët ndaj shqiptarëve, gjatë viteve 1912 - 1914, të cilët synonin të aneksonin me çdo kusht, viset e Shqipërisë së Jugut;

Së dyti, ishte përpjekja e grekëve, për më tepër se një shekull, për ndryshimin e kombësisë së tyre me forcë dhe çdo mjet tjetër;

Së treti, shqiptarët e Amerikës, konstatojnë se disa prej Fuqive të Mëdha, si Austro-Hungaria dhe Italia synonin të ndërtonin një shtet, në të cilin do të jetonin së bashku shqiptarët e tre besimeve fetare.

Natyrisht, që në intensifikimin e ndjenjës së atdhedashurisë të shqiptarëve të SHBA-së, ndikuan edhe faktorë të tjerë, si: kushtet e vështira të punës dhe të jetesës së tyre, qenia larg atdheut, gjendja e vështirë ekonomike, lidhjet e forta familjare dhe ato krahinore. Të gjitha këto së bashku e forcuan ndjenjën e solidaritetit, të bashkëpunimit dhe të bashkimit të shqiptarëve. Në mënyrë të veçantë, ndikoi jetesa e emigrantëve shqiptarë në shtëpi të përbashkëta të marra me qira, në të cilat jetonin grupe prej 10 deri në 15 vetash. Për shkak të mallit dhe dëshirës së tyre për të qenë në kontakt me familjet e tyre, te shqiptarët ndihej nevoja që të mësonin të shkruanin e lexonin në gjuhën shqipe dhe të mbanin korrespondencë përmes letrave me të afërmit e tyre. Për realizimin e kësaj nevojë, patriotët shqiptarë vijuan hapjen e kurseve të mësimt të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze. Gjithashtu, leximi i gazetës “Dielli”, në mesin e grupeve të mëdha të shqiptarëve, ndikoi që ata të njiheshin më mirë me gjendjen e shqiptarëve por edhe me vendin në të cilin ndodheshin. Falë kurseve të gjuhës shqipe, si dhe përhapjes së shtypit të shkruar në mesin e shqiptarëve, në vitin 1919, u arrit që nga 40.000 emigrantë shqiptarë, rreth 37% e tyre dinin të lexonin e të shkruanin në gjuhën shqipe¹⁶. Ndryshe nga më parë, tashmë ata

¹⁶ Joseph Swire, *Albania. The Rise of a Kingdom*, New York: Arno Press, 1971, p. 69.

deklaroronin hapur dhe me krenari se ishin shqiptarë, si dhe demaskonin që përpiqeshin ta fshihnin identitetin e tyre kombëtar¹⁷.

Elita nacionaliste e shqiptarëve të Amerikës, ndërtoi modelin e “nacionalizmit etnik”, i cili iu imponua shqiptarëve kryesisht nga rrethanat e vështira në të cilat ata ndodheshin, siç ishte rreziku i asimilimit grek të popullsisë shqiptare që banonte në viset jugore të Shqipërisë¹⁸. Ky model nacionalizmi i përshtatej më mirë shqiptarëve, të mësuar me lidhjet e tyre tradicionale të gjakut dhe farefnisnë, të cilët tashmë gjendeshin përballë kontrastit të fortë të jetës moderne në “tokën e panjohur”. Nacionalizmi etnik ishte përhapur më herët te popujt e tjerë të Ballkanit, ndaj shqiptarët jo vetëm që e aplikuan njësoj si fqinjët e tyre, por ata e konsideruan si mjetin e duhur për t’iu kundërvënë aspiratave të nacionalizmave etnikë fqinj. Duke marrë parasysh arsyet e lartpërmendura, veprimtaria e elitës drejtuese të Federatës Panshqiptare “Vatra” u mbështet në idenë, se shqiptarët duhej të punonin së bashku, sepse ishin të një gjaku, flisnin të njëjtën gjuhë dhe kishin tradita dhe zakone të përbashkëta.

Pavarësisht se nacionalizmi i diasporës shqiptare në SHBA, mori tiparet e nacionalizmit etnik, tipar themelor i tij ishte se ai u formua dhe u zhvillua si nacionalizëm “mbrojtës”, nën trysninë e rrethanave të vështira në të cilat u ndodhën shqiptarët dhe shteti i tyre. Faktorët që moderuan qëndrimin e nacionalizmit shqiptar ishin: ekzistenca e tre besimeve fetare, vështirësitë e ndeshura gjatë procesit të ndërtimit të shtetit të ri si dhe prania e një minoriteti në numër të vogël në Shqipëri, i cili nuk ishte në gjendje që të gërryente apo t’i kundërvihej shumicës etnike shqiptare brenda shtetit shqiptar. Madje, problemet dhe vështirësitë e ndeshura nga shqiptarët, patën si rrjedhojë pozitive, kultivimin tek ata, të vlerave të tolerancës fetare. Nacionalistët e diasporës shqiptare të SHBA-ës kërkonin të përcillnin në atdhe, frymën e modernizmit, larg influencës turke dhe greke. Udhëheqësit e “Vatrës” mbështetën parimin se “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Me këtë ide, ata mendonin se shqiptarët do të arrinin t’i bënin ballë presionit të madh grek dhe sllav.

Veprimtarët kombëtarë në SHBA, u shprehën se para shqiptarëve kishte dy çështje kryesore të pazgjidhura: caktimi i kufijve me fqinjët dhe

¹⁷ *Dielli*, nr. 214, Boston, Mass., 27 maj 1913, f. 3.

¹⁸ *Po aty*, nr. 234, Boston, Mass., 8 gusht 1912, f. 1.

zgjedhja e princit të Shqipërisë. Çështja e parë kishte rëndësi ekzistenciale për shqiptarët, ndërsa e dyta, përmblihte qëllimin e të gjithë shqiptarëve kudo që gjendeshin. Princi i Shqipërisë do të ishte simboli përbashkues i të gjithë shqiptarëve brenda dhe jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar.

Përfaqësuesit e “shqiptarizms”, mendonin se për Shqipërinë dhe shqiptarët, ishte momenti që “të arratiseshin nga Lindja” dhe të përqafohin frymën moderne oksidentale¹⁹. Faik Konica u shqua më tepër në këtë drejtim. Ai kundërshtoi idenë e zgjedhjes së një princi mysliman, sepse sipas tij, ky do të ishte një rrezik për të ardhmen e Shqipërisë. Zgjedhja e një princi mysliman, do të thoshte që Shqipëria, të shihej në sy të botës si një shtet oriental, të cilin do ta përdornin fqinjët si të donin. Ai mendonte se kjo do të ishte negative edhe nga pikëpamja e administrimit të vendit dhe e mendësisë, pasi modeli i administratës së vjetër, ishte i ndryshkur. Ndërsa, me një princ të krishterë, shqiptarët do të bëheshin një komb i përparuar evropian. Kjo do ta lidhte Shqipërinë përgjithmonë me Evropën, si dhe do t’i hapte asaj plotësisht burimet e kulturës perëndimore²⁰.

Gjatë viteve 1913 - 1914, gazeta “Dielli” kritikoi idetë dhe lëvizjet që synonin të përmbysnin ato çfarë ishin arritur deri në atë kohë në Shqipëri. Sipas saj, “na dalin ca Turkomanë ... edhe na thonë, javashni se edhe ron Baba Dovleti; Sulltani prapë do t’ë marrë vendin t’onë; mos kujtoni se Shqipëria do të bënet më vehte”. Shqiptarët e Amerikës, reagues gjithashtu kundër qëndrimit që mbanin disa shqiptarë “grekomanë”. Ata u shkarkuan atyre, të gjithë përgjegjësinë për çfarë i kishte ndodhur Shqipërisë deri atëherë. Ndër të tjera, ata shpreheshin se “këta na plas në shpirtin; këta na copëtuan gjysmën e Shqipërisë; këta janë shkakëtarët që humbëm Janinën, Kosovën dhe Manastirin; këta...me protestimet e tyre, na suallë dëme të mbëdha, prandaj nukë duhet t’i afërojmë.... Për këta tradhëtorë Qeveria Shqipëtare duhet të marrë masa, se këta do të jenë kurdoherë të dëmshëm për kombin t’onë”²¹.

¹⁹ Enis Sulstarova, *Arratisje nga Lindja. Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, botim i dytë, Tiranë: Duda, 2007, f. 25.

²⁰ *Dielli*, nr. 260, Boston, Mass., 7 nëntor 1913, f. 1.

²¹ *Po aty*, nr. 238, Boston, Mass., 22 gusht 1913, f. 1- 2.

Drejtimesit e “Vatrës” vlerësuan përpjekjet e Sali Butkës për mbrojtjen e viseve jugore. Ata u përpoqën që t’ua bënin të qartë shqiptarëve të Amerikës se, grekët po vrisnin bashkatdhetarët dhe po u merrnin atyre, nderin, gjënë më të shtrenjtë. Vatranët u bënë thirrje shqiptarëve të Amerikës që të niseshin për në atdhe për të shpëtuar vëllezërit e tyre. Falë propagandës dhe veprimtarisë së nacionalistëve shqiptarë të Amerikës, një pjesë e shqiptarëve të gënjyer nga grekët deri në atë kohë, filluan të ndryshonin qëndrim²². Ata përcaktuan si probleme shqetësuese për shqiptarët, paditurinë, fanatizmin fetar dhe dëshirën e një pjese të parisë së vendit për të mbajtur popullin në errësi. Prandaj, për tejkalimin e këtyre problemeve, Shqipëria e kishte të domosdoshme ndihmën e bijve të saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Përmes gazetës “Dielli”, nacionalistët shqiptarë propaganduan idenë se shqiptarët e Shqipërisë nuk mund të ishin të lumtur, për sa kohë që e gjithë Kosova dhe gjysma e Toskërisë do të mbeteshin nën zgjedhën e huaj²³. Megjithëse shumica e shqiptarëve të Amerikës vinin kryesisht nga krahinat e Korçës, Kolonjës dhe Gjirokastrës, ata i përfytyronin trojet e Shqipërisë së Sipërme dhe të Çamërisë brenda kufijve të kombit të tyre²⁴.

Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, drejtimesit e “Vatrës” hartuan një program politik²⁵, i cili synonte bashkimin e shoqërive të ndryshme jashtë vendit në një të vetme, mbi bazën e parimeve kombëtare. Ky program do të shërbente për të ndihmuar çështjen kombëtare dhe shtetin shqiptar pas luftës. Mirëpo, ndonëse kjo platformë u pranua në parim, ajo u zbatua pjesërisht për shkak të mosmarrëveshjeve mes shqiptarëve.

Shqiptarët e Amerikës punuan për çështjen kombëtare shqiptare, edhe gjatë kohës kur mbahej Konferenca e Paqes në Paris. Qëllimi kryesor i përpjekjeve të “vatranëve” ishte riafirmimi i statusit politik të shtetit shqiptar si dhe ruajtjen e Korçës dhe të Gjirokastrës brenda kufijve të Shqipërisë. “Vatra” arriti kulmin e fuqisë së saj në vitet 1918 - 1920. Gjatë kësaj periudhe, ajo u masivizua në radhët e diasporës shqiptare, për shkak të një organizimi më të mirë të saj, si dhe të shtimit të numrit të

²² *Po aty*, nr. 239, Boston, Mass., 26 gusht 1913, f. 2.

²³ *Po aty*, nr. 241, Boston, Mass., 2 shtator 1913, f. 1.

²⁴ B. R. O’G Anderson, *Imagined Communities...*, p. 9.

²⁵ *AQSH*, F. 100, V. 1915, D. 11, fl. 1-2. Raport i një personi [të cilit nuk arrihet t’i lexohet emri – S. K.] drejtuar Federatës “Vatra”, Natick Mass., 1 Vjesht’ e parë 1915.

anëtarëve. Shqiptarët e Amerikës patën shpresë të madhe te presidenti amerikan Uillson. Ata shihnin tek ai, mbrojtësin e drejtësisë, të pavarësisë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë²⁶.

Drejtim tjetër i kontributit që dhanë nacionalistët e diasporës shqiptare në SHBA, ishte ndihma financiare. Ata mendonin se ishte detyrë e shqiptarëve të Amerikës, të ndihmonin financiarisht popullin dhe shtetin e tyre²⁷. Me shpenzimet e “Vatrës”, gjatë viteve të luftës dhe në mbarim të saj, u dërguan ndihma për vëllezërit e tyre në Shqipëri, u financuan disa delegatë shqiptarë që punonin për çështjen kombëtare në vende të ndryshme të Evropës, u organizuan manifestime, si dhe u dërguan mjaft telegrame proteste qeverive të ndryshme. Shuma e shpenzimeve të bëra nga “Vatra” si “zëvendëse e Shtetit”, arrinte rreth 197 000 dollarë.

Falë mbështetjes morale e financiare të shqiptarëve të Amerikës, por edhe përpjekjeve të tyre për të lobuar dhe tërhequr simpatinë e mbështetjen e qytetarëve dhe zyrtarëve të administratës amerikane²⁸, u arrit që të mbrohej ekzistenca e shtetit të tyre. Në mbarim të Luftës së Parë Botërore deri në fillim të vitit 1921, mjaft shqiptarë u larguan nga Amerika dhe u kthyen në atdhe për të ndihmuar në ringritjen e shtetit shqiptar.

Pas vitit 1920, drejtuesit e shtetit shqiptar, vlerësuan kontributin e dhënë nga shqiptarët e Amerikës dhe Federata Panshqiptare “Vatra” për ndërtimin e tij. Për këtë arsye, në vitin 1921, u vendos që Federata Panshqiptare “Vatra”, të kishte përfaqësuesin e saj në Parlamentin Shqiptar.

Në vitet 1920 - 1921, “Vatra” organizoi fushatën në ndihmë të shtetit shqiptar. Në përfundim të saj, u mblodhën mbi 200 000 dollarë nga shqiptarët e Amerikës. “Vatra” dërgoi një çek prej 5 000 dollarësh për vëllezërit e tyre të dëmtuar nga tërmeti i rënë në krahinën e Tepelenës²⁹,

²⁶ H. Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA...*, f. 41.

²⁷ *AQSH*, F. 100, V. 1921, D. 22, fl. 17. Thirrje dhe ftim për gjithë shqiptarët dhe shqipëtarë të New Bedford-it – nga Halil Borshi [1921].

²⁸ *Po aty*, F. 100, V. 1921, D. 31, fl. 1. Ftesë e Federatës “Vatra”, e cila fton publikun në një takim mbasditje, ku do të flitet për historinë dhe kulturën e popullit shqiptar nga personalitete amerikane, 1921.

²⁹ *Po aty*, F. 100, V. 1921, D. 22, fl. 10-13. Letër e Kryetarit të Federatës Panshqiptare “Vatra”, drejtuar Kryeministrit të shtetit shqiptar, Ilias Vrionit, Boston Mass., 13 prill

si dhe një shumë prej 1 000 dollarësh për të ndihmuar shqiptarët në Rusi, të prekur rëndë nga kriza e urisë që mbërtheu shtetin sovjetik. Gjithashtu, ajo botoi mbi 100 000 libra shkollorë dhe artistikë³⁰.

Diaspora shqiptare e Amerikës dëshironte që shteti i ri shqiptar, të vendosej sa më parë, mbi baza moderne perëndimore. Por realiteti ekonomik, social dhe politik, në Shqipëri ishte krejt tjetër. “Vatra” i rriti kritikën në shtyp ndaj qeverisë shqiptare veçanërisht pas vitit 1922. Në faqet e gazetës “Dielli” kritikoheshin dukuri negative të tilla, si: emërimi i nëpunësve të administratës shqiptare mbi bazën e lidhjeve krahinore, nxitja e përçarjes fetare mes shqiptarëve, forcimi i egoizmave personale dhe i luftës për pushtet politik si dhe i prirjes së bejlerëve për të sunduar në Shqipëri³¹. Drejtuesit e “Vatres” mendonin se detyra kryesore e qeverisë, ishte rritja e mirëqenies së popullit dhe forcimi i shtetit shqiptar për ta bërë Shqipërinë një Zvicër të Ballkanit³².

Nga viti 1922, “vatranët” arritën në përfundimin, se qeveria shqiptare, po nxiste një grup njerëzish për të indoktrinuar popullin me dogmën e ndarjes së shqiptarëve në “gegë” dhe “toskë”, por edhe duke futur përçarjen në mesin e ortodoksëve të Shqipërisë së Jugut³³. Qeveria shqiptare, iu kundërpërgjigj këtyre kritikave, duke ndaluar përkohësisht, hyrjen e gazetës “Dielli” në Shqipëri. Për rrjedhojë, marrëdhëniet ndërmjet qeverisë shqiptare dhe drejtuesve të Federatës “Vatra”, u ftohën.

Në Shqipëri u krijuan dy grupime politike. Opozita drejtohej nga Fan Noli dhe mbështetej nga Federata Panshqiptare “Vatra”, ndërsa shumica drejtohej nga Ahmet Zogu. Fan Noli kishte bindjen, se në qeverinë shqiptare dominonte prirja autoritare, e cila e kishte futur shtetin shqiptar në një rrugë të gabuar³⁴.

1921; *po aty*, F. 100, V. 1921, D. 29, fl. 1-6. Raport për mbledhjen e mbajtur më 2-3 janar 1921 nga Këshilli i “Vatres”, Boston Mass., 20 janar 1921.

³⁰ “Ndihmat e Vatres arrine ne Odese”, *Dielli*, nr. 2550 – (93), Boston, Mass., 20 janar 1923, f. 8; *po aty*, “Vatranet per shqiptaret pertej”, nr. 2551 – (94), Boston, Mass., 24 janar 1923, f. 4.

³¹ “Ca te memes, ca te njerkes!”, *Dielli*, nr. 2569 – (112), Boston, Mass., 28 mars 1923, f. 8; *po aty*, “Kriza politike ne Shqiperi – F. Konitza”, nr. 2572 – (115), Boston, Mass., 7 prill 1923, f. 4.

³² *Dielli*, nr. 2422, Boston, Mass., 29 prill 1922, f. 7.

³³ *Po aty*, nr. 2347, Boston, Mass., 28 janar 1922, f. 3.

³⁴ “Nga Shqiperia! ‘Ne buze te Gremines’”, *Dielli*, nr. 2536 – (79), Boston, Mass., 29 nëntor 1922, f. 6.